REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 913/19
Datum 12.12.19
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **MINISTRIA E DREJTËSISË**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **21500-19-7374-1-1-1**

Sa i përket tenderit për **Furnizimi me automjet për transportin e veturave**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Profitech sh.p.k.
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. Ilaz Kodra Nr. 5
(Adresa)
Prishtinë *10000*
(Vendi) *(Kodi postar)*
044 784 278 _____
(Numri Telefonit) *(Numri i Faks-it)*

Burim Vrajolli
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)
profitech.shpk@gmail.com
(Adresa elektronike)

12.12.2019 _____
(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____
(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi per Kontratë; Data e publikuar: ***01.10.2019***
Formulari standard per korrigjimin e gabimeve ; Data e publikuar: ***21.10.2019***
Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues; Data e publikuar: ***25.11.2019***
Afati i fundit për dorëzimin e tenderit: ***23.10.2019 në 14:00 orë***
Kriteri per dhënie te kontratës: ***Çmimi më i ulët***

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ **Jo** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☐ Jo ☐

*Me date **27.11.2019** kemi bere kerkese per rishqyrtim prane AK "Ministria e Drejtesise" Te bashkangjitur mund te gjeni Kerkesen per Rishqyrtim si dhe vendimin nga AK "Ministria e Drejtesise" te cilin e kemi pranuar me date: **04.12.2019***

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Në bazë të **Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092**
Eshte shkelur Neni 59, Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i **Tenderëve**

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Në: Seksioni II. FLETA E TË DHENAVE tË Tenderit (FTD)

Tek: Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, Neni 9.1 & 9.2, pika 3.

Eshte kerkuar;
OE ne rast se nuk është vet prodhues atëherë duhet të ofroje dëshmi autorizimin nga prodhuesi apo dileri i autorizuar nga prodhuesi për shitje te këtyre produkteve (Autorizimi duhet të jetë me emër të projektit dhe numër të prokurimit për këtë tender qe oferton. Autorizim për shitje i lëshuar nga prodhuesi ose dileri)

Ne sikurse edhe ne "Sqarimin" tone te derguar me date **06.11.2019** bazuar ne "**Letren Standarde te Kerkeses per Sqarimin e Tenderit**" te derguar nga AK me date: **04.11.2019**

Ju njoftojme se si pjese e dosjes se tenderit nga ana jone eshte dorezuar Auotirzimi nga Prodhuesi EKIP,

Vendimi i marre nga ana e komisionit vleresues se: *Mungon Autorizimi nga Prodhuesi apo dileri i autorizuar nga prodhuesi per shitjen e ketyre Produkteve* eshte plotesisht i pa bazuar dhe nuk qendron.

Autorzimi ne fjale eshte i leshuar nga Prodhuesi EKIP qe eshte prodhues i mbindertimit, ne baze te kerkeses te klientit porositet automjeti i cili i pershtatet mbindertimit sic mund te jene prodhues te ndryshem te kamioneve, nuk ka mundesi te kerkohet Autorizim parcial pavaresisht se cfare pjese permban automjeti pasi qe automjeti per transportin e veturave del si produkt final nga Prodhuesi EKIP, ky automjet eshte si teresi andaj edhe Autorizimi eshte valid dhe e mbulon Automjetin per Transportin e Veturave.

Sa i perket vendimit nga Komisioni Vleresues se oferta jone ka cmimin me te larte se cmimi i tregut poashtu eshte i pabazuar dhe nuk qendron perderisa vlera e parashikuar nga ana e AK-se eshte **170,000.00 Euro** dhe cmimi jone eshte nen vleren e parshikuar nga ana e AK-se.

Kerkojme nga ana juaj qe lenda te kthehet ne rivleresim dhe oferta jone te shpallet e pergjegjshme.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
e) *bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
f) *Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe*
g) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*